



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**

**KORCE**

**NR. REGJ.THEM.454Regj**  
**DATA E ARDHJES 08.10.2013**

**NR.VENDIMI 454 Regj**  
**DT. VENDIMIT 12.10.2013**

**VENDIM**

**“ NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, e perbere prej:

Gjyqtar \_\_\_\_\_ **Maksim Qirjazi**

asistuar nga sekretare Ernesta Cilja, ne Korce, sot me date 12.10.2013, ora 10.00, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura, ceshtjen e vecante penale me Nr. Regj.Them 454 Regj. data e ardhjes 08.10.2013akti qe i perket:

**KERKUES:** Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Korce, perfaqesuar nga Prok. Elsion Sadiku.

**OBJEKTI :** Vendosja e mases se sigurimit pasuror, sekuestro prevendive mbi pasurine me nr.1105/3, regjistruar ne Vol17, fq 184, zeri kadastra trualli, me siprfaqe 966 m2, nga te cilat 299.34 m2, regjitruar ne emer te shtetesit Erindi Cibuku, per shkak se dyshohet se eshte produkt i vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale” te parashikuar nga neni 287 i K Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen ne teresi, degjoi prokurorin e ceshtjes, i cili ne perfundim te seances gjyqesore, kerkoi: pranimin e kerkeses.

**VEREN:**

Me vendimin Nr.329 regj. Date 02.09.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, ka vendosur : “-Pranimin e kerkeses.


*“Caktimin e mases se sigurimit personal “arrest ne burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Panale.*

**Ndaj shtetasit.** *Blendi Topalli, i biri i Andrea dhe i Shege, i datl. 05.04.1978, lindur dhe banues ne fshatin Bitincke, Rrethi Devoll, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, i padenuar me pare, me profesion ekonomist, me detyre, Drejtor i deges se : Raiffesen Bank”, Bilisht.*

**I hetuar veprat penale te** : *“-Fallsifikimit te dokumentave” (ne formen e falsifikimit intelektual).*

*“-Pastrimit te produkteve te vepres Penale te vjedhjes, duke shperdoruar detyren”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287 dhe 135 te K.Penal*

*-Urdherohet policia gjyqesore me ekzekutimin e ketij vendimi arresti.”*

  
-Kunder këtij vendimi, mund të bëhet ankim brenda 10 diteve, nga zbatimi ose njoftimit të vendimit të Gjykatës, në Gjykatën e Apelit Korçë.”

Gjate hetimit gjyqësor nga ana e organit hetimor janë zbuluar fakte dhe rrethana të reja që implikojnë shtetasin e dyshuar Blendi Topolli, tashme në gjendje arresti, lidhur me transaksionet faktike të kryera prej tij për një prone pasuri të palujtshme, send i cili konsiderohet prej organit procedues si produkt i veprës penale, që lidhet me veprën penale që ky i dyshuar ka kryer, e cila mund të të rendojë ose të zgjase pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, kjo referuar nenit 274/12 të K.Pr.Penale.

Ky gjykim i vecantë, në kuptim të neneve 69, 74 e 76 të K.Pr Penale, i perket juridiksionit penal dhe persë i perket gjykimit, është në kompetencë lëndore dhe tokësore të Gjykatës të Shkallës të Parë Korçë, (kjo persë i perket vendit, ku është kryer vepra penale).

Prokurori i parashtrori rrethanat e faktit të formësuar në këte mënyre :

Prokuroria e rrethit gjyqësor Korçë ka filluar procedimin penal nr. 1415/1 të vitit 2012, ndaj shtetasit: **Blendi Topalli**.

Për këtë person ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprat penale të “Fallsifikimit të dokumentave” (në formën e fallsifikimit intelektual), “Pastrimit të Produkteve të veprës penale” dhe “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287 dhe 135 të K.Penal.

Nga të dhënat që i bashkohen kërkesës, rezultojnë se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, mbi bazën e kallzimit me gojë të bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë të shtetasit Sotir Hysi dhe të dokumentave të paraqitura nga ky shtetas, ka rregjistruar procedimin penal nr. 1415, të vitit 2012, për veprat penale të “fallsifikimit të dokumentave” dhe “Shpërdorimit të Detyrës”, të parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal.

Nga hetimi në lidhje me këtë procedim penal ka rezultuar se vëllai i kallzuesit (shtetasi Andon Hysi), ka marrë një hua në Fondin e Financimit të Zonave Malore në shumën 700 000 lekë për blerjen e një mjete transporti dhe për përmbushjen e këtij detyrimi ka vënë në hipotekë pasurinë nr. 746/59, e cila është një tokë bujqësore në fshatin Bitinckë dhe pasuri e përfutur nga familja bujqësore. Kallzuesi, pretendon se në kontratën e përmëndur më sipër ka firmosur vetëm ai (vëllai i tij Andon Hysi) dhe jo nëna dhe babai i tij.

Gjithashtu, ndër të tjera kallzuesi Sotir Hysi, ka pretenduar se nga ana e përfaqësuesit të Fondit të Financimit të Zonave Malore z. Robert Bregu, është paraqitur në seancën gjyqësore një deklaratë noteriale me të njëjtën datë që është përpiluar dhe kontrata e mësipërme, sikur kallzuesi dhe motra e tij (Julinda Hysi) që banon në Tiranë, janë paraqitur tek noteri dhe kanë deklaruar se janë dakort për përpilimin e kontratës së huasë si dhe vënien e tokës në hipotekë. Edhe ky dokument sipas kallzuesit është tërësisht i fallsifikuar sikurse kontrata e huasë e përcaktuar më sipër.

Në lidhje me këtë procedim penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore si sekuestrimi i kontratave origjinale dhe i deklaratave origjinale të përpiluara tek noteri, janë pyetur si

persona që deklarojnë rrethana të dobishme për hetimin shtetasit Andon Hysi, Agron Hysi, Julinda Hysi, Sotir Hysi, Mirandi Kaso dhe Robert Bregu, si dhe janë marrë modele eksperimentale shkrimi dhe nënshkrimi nga shtetasit që kanë firmosur kontratat e huasë dhe hipotekimit e dt 27.02.2008.

Nga akti i ekspertimit grafik nr. 11. dt 17.01.2011 dhe nga akti i ekspertimit grafik nr. 1248 dt 31.01.2013, ka rezultuar se kontratat në fjalë dhe deklaratat, janë firmosur vetëm nga shtetasi Andon Hysi dhe vëllai i tij Sotir Hysi (kallzuesi), por nuk janë firmosur nga dy prindërit dhe motra e tij.

Në datë 27.02.2013, është vendosur ndarja e procedimit penal nr. 1415, i vitit 2012, në dy procedime penale më vete, më konkretisht: Në proçedimin penal Nr. 1415, në ngarkim të pandehurit Andon Hysi, i akuzuar për veprën penale veprën penale të "Fallsifikimit të dokumentave", (në formën e përdorimit), të parashikuar nga neni 186/1 I K.Penal dhe proçedimin penal Nr.1415/1 për sa i përket shtetasit nën hetim Jorgo Gjamo, i hetuar për veprën penale të "Shpërdorimit të Detyrës", të parashikuar nga neni 248 I K.Penal.

Kjo duke pasur parasysh faktin se: Përsa i përket të pandehurit Andon Hysi, i cili akuzohet për veprën penale të veprën penale të "Fallsifikimit të dokumentave", (në formën e përdorimit), të parashikuar nga neni 186/1, i K.Penal, hetimi në ngarkim të këtij të pandehuri është përfunduar dhe nuk kishte nevojë për hetime të mëtejshme (aktualisht ai është duke u gjykuar). Ndërsa në lidhje me shtetasin Jorgo Gjamo, i hetuar për veprën penale të "Shpërdorimit të Detyrës", të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, ishte e nevojshme edhe kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore, të cilat kanë të bëjnë me sqarimin e momentit se, prej cilit person janë paraqitur dokumentat dhe kontrata e huasë dhe hipotekimit tek noteri, raportet e këtij shtetasi me shtetasin Mirandi Kaso dhe me shtetasin Blendi Topalli, si dhe një sërë pretendimesh të cilat u ngritën ndaj shtetasit Blendi Topalli nga i pandehuri Andon Hysi në përfundim të hetimit ndaj tij.

Në lidhje me procedimin penal nr. 1415/1 të vitit 2012, janë kryer një sërë veprimesh hetimore, duke u përqëndruar në pretendimet e shtetasve Julinda Hysi, Andon Hysi dhe në lidhje me fatin e pasurisë me nr. 746/59.

Nga veprimet hetimore në lidhje me këtë procedim pena,l kanë rezultuar një sërë faktesh si më poshtë:

Pasurinë me nr. nr. 746/59, për të cilën është nisur ky procedim penal. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm në ankandin e zhvilluar në datë 15.07.2011, e ka blerë (de fakto) shtetasi Blendi Topalli, me detyrë Drejtor i Degës së "Raiffeissen Bank" Bilisht. Pavarsisht se nga dokumentacioni i administruar nga përmbartuesi privat Spartak Ceta, pjesmarrës në ankandin e datës kanë qënë shtetasit Erindi Çibuku dhe shtetasia Vlabona Lala. Të dy këta persona realisht nuk kanë marrë pjesë në ankand, pasi kuotat e pjesmarrjes së tyre dhe më pas shumën me të cilën është blerë kjo pasuri e ka kryer shtetasi Blendi Topalli, i cili ka përdorur kushëririn e tij Erindi Çibuku dhe shtetasen Valbona Lala ( e njohura e tij), në këtë procedurë ankandi. Kjo pasuri që ai ka blerë nëpërmejt kushëririt të tij Erindi Çibuku në shumën 1 440 192 lekë, është shitur menjëherë pas dy ditësh (pas rregjistrimit) tek shtetasi Melsi Topçiu, për shumën 3 500 000 lekë. Këto fakte i ka pranuar edhe vetë shtetasi Blendi Topalli, cili është justifikuar

me faktin se për të mos marrë miratim nga Departamenti Ligjor i bankës, ku punonte, ka përdorur kushëririn e tij për të blerë këtë pronë.

Bazuar në këto fakte, në lidhje me këtë procedim penal në datë 06.05.2013, i është regjistruar si person që i atribuohet vepra penale edhe emri i shtetasi Blendi Topalli, i hetuar për veprat penale të të "Fallsifikimit të dokumentave" (në formën e fallsifikimit intelektual) dhe "Pastrimit të Produkteve të veprës penale" të parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287 të K.Penal.

Nga hetimi i mëtejshëm në lidhje me këtë procedim penal dhe më konkretisht në lidhje me burimin e shumës me të cilën është blerë pasuria nr. 746/59, ka rezultuar se, kjo shumë është paguar nga llogaria e shtetasit Niko Zere.

I pyetur me cilësinë e personit që deklaroi rrethana të dobishme për hetimin e shtetasit Niko Zere, në datë 23.07.2013, ka sqaruar se, nuk ka transferuar asnjëherë për llogari të shtetasit Erindi Çibuku ndonjë shumë lekësh, pasi këtë shtetas nuk e njeh dhe për më tepër ai nuk ka transferuar asnjë shumë lekësh për llogari të ndonjë ankandi nga shuma që ai ka depozituar në ankand. Madje ky shtetas ka sqaruar se pikërisht në vitin 2013, është thirrur nga shtetasi Blendi Topalli rreth fundit të muajit Maj, ose në muajin Qershor, për të bërë siguracionin shëndetsor në bankë. Atje Blendi i ka sqaruar se sigurimi shëndetsor për të nuk mund të bëhej, pasi ai ishte mbi 65 vjeç, por mund të bëhej për djalin dhe nusen e tij. Shtetasi Niko Zere, ka sqaruar gjithashtu se Blendi Topalli, i kishte dhënë disa dokumenta për të firmosur dhe ndër të tjera i ka thënë se: "*Niko, është bërë një gabim në emrin tënd, janë hedhur 10 000 euro*". Shtetasi Niko Zere, ka sqaruar se ai nuk e kishte kuptuar nëse ishin marrë nga llogari, apo ishin hedhur në llogarinë e tij, këto para, por i ka thënë Blendit se: "*Djalë unë as kam tërhequr dhe as nuk kam derdhur para në euro absolutisht, ti bëj sit ë duash unë nuk kam punë me këto*". Gjithsesi ai ka sqaruar se nuk kishte kryer asnjë transaksion me llogarinë e tij.

Duke ju referuar fakteve të mësipërme dhe aktit të ekspertimit grafik nr. 153 dt 31.07.2013, dyshohet se në mirëbesim, shtetasi Blendi Topalli, i ka marrë firmën shtetasit Niko Zere, për transfertën në favor të shtetasit Erindi Çibuku, gjatë kohës që dokumenti në fjalë kërkohej për tu sekuestruar nga ana e Prokurorisë në cilësinë e provës materiale (për këtë arsye ky document është dorëzuar me shumë vonesë nga personi nën hetim shtetasi Blendi Topalli).

Në vijim të veprimeve hetimore në lidhje me këtë procedim penal me shkresën nr. 14729/1 Prot dt 07.08.2013, nga ana e "Raiffessen Bank", është dërguar informacioni për gjëndjen e llogarisë dhe lëvizjet në llogarinë me nr. 0000432428, në emër të shtetasit Niko Xhevair Zere i dtl 01.08.1943. Nga informacioni i bankës, ka rezultuar se përveç transaksionit të kryer për llogari të shtetasit Erindi Çibuku, rezulton se nga kjo llogari janë kryer edhe tre transaksione të dyshimta, më konkretisht:

- Po në datë 28.07.2011 (datë në të cilën është bërë transferimi për llogari të Erindi Çibukut). Nga llogaria e shtetasit Niko Zere, është kryer transaksioni me vlerë 2 140 000, me përshrim (blerje apartamenti 54 m në Vlorë), me përfituese shtetasen Afrovita Anesti Thimojani.
- Në datë 27.10.2011 Nga llogari e shtetasit Niko Zere, është kryer transaksioni me vlerë 3 123 000, me përshrim (blerje apartamenti), me përfitues shtetasin Artan Skënder Guzi.

- Në datë 13.02.2013 Nga llogaria e shtetasit Niko Zere, është kryer transaksioni me vlerë 6 300 000, me përshrim (blerje toke), me përfitues shtetasin Jani Jorgo Kambo.

Si rezultat i transaksioneve të mësipërme llogari bankare me nr. 0000432428, në emër të shtetasit Niko Xhevair Zere i. dtl 01.08.1943, nga shuma 13 969 000 lekë që duhet të ishte gjëndje. Gjëndja aktuale e saj është 79, 599 lekë.

Në lidhje me fakte e mësipërme dhe transaksionet e kryera nëpërmjet llogarisë së shtetasit Niko Zere, në datë janë pyetur me cilësinë e personave që deklarojnë rrethana të dobishme për hetimin edhe shtetasit Niko Zere dhe djali i tij Andrea Zere, të cilët kanë sqaruar se nuk kanë asnjë dijeni për transaksionet e mësipërme, nuk kanë blerë asnjë tokë, asnjë apartament dhe nuk i njohin asnjë prej përfituesve të këtyre transaksioneve.

Duke ju referuar këtyre të dala rishtazi nga hetimi, egzistojnë dyshime të arsyeshme se përveç elementëve të veprës penale të “Fallsifikimit të dokumentave” (në formën e fallsifikimit intelektual) dhe “Pastrimit të Produkteve të veprës penale” të parashikuar nga nenet 186/1 dhe 287 të K.Penal. Shtetasi Blendi Topalli, ka konsumuar edhe elementët e veprës penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar nga neni 135 i K.Penal.

Pas ekzekutimit të masës së sigurimit të dhene nga kjo gjykate sa me sipër, me date 03.09.2013 kanë dale nje sere faktesh te reja te cilat kane nevojë per hetim. Me konkretisht, ka rezultuar se sikurse shtetasi Niko Zere, u jane vjedhur depozitat edhe 57 personave te tjere. Perfitues te ketyre shumave (nepërmjet transfertave) rezultojne 37 persona te ndryshem, te cileve ju jane transferuar nga nje ose nga me shume raste, shumat e depozituara nga klientet. Per shkak te kompleksitetit te kesaj ceshtje penale, jane angazhuar dhe 4 Oficere te Policise Gjyqesore te tjere.

Nga hetimi i deritanishem rezulton se shtetasi Blendi Topalli, ka vjedhur duke shpërdoruar detyren nje shume te perafert me 2 800,000 euro. Te cilat egzistojne dyshime te arsyeshme se, ai i ka perdorur pervec te tjerave edhe per te blere pasuri te palujtshme, sikurse eshte rasti i pasurise me nr. 1105/3 regjistruar ne Vol 17, fq 184, zeri kadastral truall, me sipërfaqe 966 m2, nga te cilat 299.34 m2, jane ndertese, regjisruara ne emer te shtetasit Erindi Cibuku. Kjo pasuri eshte blere nepërmjet se ekspertimit grafik nr.153 date 31.07.2013, shumat e lekeve per blerjen e kesaj pasurie I ka paguar shtetasi Blendi Topalli.

**Nisur nga sa me sipër, Gjykata pasi çmoi rrethanat e faktit dhe vleresoi provat e paraqitura, arsyeton se, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit, persa i perket caktimit të masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive mbi pasurine me nr.1105/3, regjistruar ne Vol.17, fq 184 zeri kadastral, trualli me sipërfaqe 966 m2, nga te cilat 299.34 m2, te regjistruar ne emer te shtetasit Erindi Cibuku, per shkak se, dyshohet se eshte produkt i vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale”, te parashikuar nga neni 287 i K Penal duhet te pranohet, sepse:**

Ne rastin konkret jemi perpara percaktimeve te bere ne Ligjin nr. 9284, date 30.09.2004, i cili ka per objekt, zbatimin e masave parandaluese pasurore ndaj personave te dyshuar per kryerjen e nje kategorie veprash penale. Veprat per te cilat dyshohet se ka kryer shtetasi i arrestuari Blendi Topalli, hyjne ne kete kategori veprash penale te caktuara. Ne kete kuptim, procedimi parandalues sipas ketij ligji, eshte i lidhur

domosdoshmerisht me qenien e nje procedimi penal, pavaresisht se ne cilen faze ndodhet ky i fundit eshte, pra, nese ka perfunduar apo jo.

Gjykata arsyeton ky procedim parandalues vijon ne menyre autonome, pra, permbueshet dhe ky kriter procedues i nevojshem, ne kete rast.

Bazuar ne provat e paraqitura nga organi procedues, si Vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce me nr. 329 date 02.09.2013, akti i ekspertimit grafik nr 153 date 31.07.2013, shkresa e Zyres V.R.P,P Devoll si dhe nje sere dokumentash te lejuara ne kete gjykim, del se, ekzistojne dyshime te arsyeshme se, pasuria me nr. 1105/3 e regjistruar ne rradhoret qe diponon kjo zyre, ne Vol17 fq.184, zeri kadastral trualli me sipërfaqe 966 m2, nga te cilat 299.34 m2, ne emer te shtetasit Erindi Cibuku, (de fakto eshte blere nga shtetasi Blendi Topalli).

Veprimet e tij per kete transakcionin, te kryera lidhur me kete prone te palujtshme, vertetohen me deklarimet e tij me deklarimet e shtetasit Erindi Cibuku, akti i ekspertimit grafik nr.153 date 31.07.2013si dhe dokumenta te tjera provuese te administruara ne kete gjykim.

Nisur sa me siper, gjykata krijon binjen se, produkti i sipercituar, rrjedh nga kryerja e nje vepre penale per te cilen ky shtetas dyshohet se ka kryer.

Ne keto kushte cmohet qe, kjo prone ne gjendje te lire ne qarkullimin civil mund te rendoje pasojat e kesaj vepre duke u tjetersuar, transformuar apo fshehur nga ana e shtetasit Blendi Topalli, nepermjet shtetasit Erindi Cibuku (kusheriri i tij).

Ne keto kushte, gjykata çmon se, kërkesa e Prokurorise, duhet te pranohet si e drejte dhe e ligjshme dhe

Per Keto Arsyë

Bazuar ne nenet 276 te K.Pr.Penale, Gjykata

Vendosi

-Pranimin e kerkeses.

-Vendosjen e mases se sigurmit pasuror, sekuestro preventive mbi pasurine me nr.1105/3, regjistruar ne Vol17, fq 184, zeri kadastra trualli, me sipërfaqe 966 m2, nga te cilat 299.34 m2, regjistruar ne emer te shtetasit Erindi Cibuku, per shkak se dyshohet se eshte produkt i vepres penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale", te parashikuar nga neni 287 i K. Penal".

-Urdhërohet organi procedures Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Korce, me zbatimin e ketij vendimi.

-Kunder ketij vendimi, mund te behet ankim brenda 10 diteve, ne Gjykatën e Apelit Korce, nga dita e zbatimi te mases, nga cilido qe ka interes.

-U shpall ne Korce, me daten 12.10.2013.

Sekretare  
Ernesta Cilja



Gjyqtar  
Maksim Qirjazi



VERTETOHET  
NJESIA E  
FOTOKOPJES  
ME ORIGINALIN  
KORCE ME 25.11.2020

*go ndodhet ne dore*  
Arhiveste Kerimete Anelli

